

Në bazë të nenit 20 dhe nenit 25 të Ligjit për shërbim gjyqësor ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr. 43/14, 98/15, 6/16, 198/18, 248/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.235/22) dhe nenit 23 të Ligjit për marrëdhënie pune ("Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë" nr.167/15, 27/16, 120/18 dhe "Gazeta Zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut" nr.110/19, 267/20, 151/21 dhe 288/21), të Rregullores për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë dhe pëlqimit nga Ministria e financave nr. 18-3334/2 të datës 24.02.2023

GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

shpall

SHPALLJE PUBLIKE NUMËR 2/2023

për punësim të 1 (një) personi për kohë të pacaktuar

1. Mjeshtër i përgjithshëm – 1 (një) realizues

Kushtet për kryerje të punëve:

Së paku arsim të mesëm profesional nga sfera përkatëse, me ose pa përvojë pune.

Orari javor i punës është 40 orë;

Orari ditor i punës është 8 orë, prej ora 07,30 deri në orën 15,30;

Rroga neto në vlerë: 20.280,00 denarë

Krahas kushteve të theksuara të posaçme, të parapara në Rregulloren për organizim të brendshëm dhe sistematizim të vendeve të punës në Gjykatën Supreme të Republikës së Maqedonisë, kandidatët për vendin e punës së theksuar duhet t'i përmbushin edhe kushtet e përgjithshme të parapara në nenin 21 paragrafi (1) të Ligjit për shërbimin gjyqësor:

- të jetë shtetas i Republikës së Maqedonisë,
- në mënyrë aktive të përdorë gjuhën maqedonase,
- të jetë i moshës madhore,
- të ketë aftësi të përgjithshme shëndetësore për vendin e punës, dhe
- me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Kandidatët e interesuar obligohen që të parashtrojnë lutje për punësim me dëshmi për përmbushjen e kushteve të përgjithshme dhe të posaçme për vendin e punës për të cilin paraqiten, në origjinal ose kopje të vërtetuara në Noter.

- Certifikatë për arsimin e kryer përkatës
- Dëshmi për përvojë pune
- Certifikatë të shtetësisë
- Certifikatë të mjekut për gjendjen e përgjithshme shëndetësore

-Vendim ose vërtetim, me vendim të plotfuqishëm gjyqësor të mos i jetë shqiptuar dënim ndalesë për kryerje të profesionit, veprimtarisë ose detyrës.

Lutja, krahas dëshmime, është e obligueshme të përmbajë, emër dhe mbiemër të kandidatit, vendbanim, gjegjësisht vendqëndrim të kandidatit, e-mail adresë dhe telefon për kontakt.

Afati për parashtimin e lutjes është 5 (pesë) ditë nga dita e publikimit të fundit të shpalljes në gazetën ditore (duke mos llogaritur ditën e vet publikimit).

Kushtet e theksuara në shpallje, kandidatët duhet t'i përmbushin në momentin e paraqitjes.

Paralajmërim: Kandidati i cili do të parashtrojë të dhëna të rrejshme do të diskualifikohet nga procedura e mëtejshme.

Fletëparaqitjet e dorëzuara pas afatit, jo tërësisht të plotësuara, të parregulluara dhe të pa kompletuara, nuk do të shqyrtohen.

Fletëparaqitjen me dëshmitë, kandidatët obligohen që t'i dorëzojnë drejtpërdrejtë në sportelin për pranimit të dokumenteve në Gjykatë, gjatë orarit të punës ose përmes adresës postare:

GJYKATA SUPREME E REPUBLIKËS SË MAQEDONISË SË VERIUT

Bul. Kërste Misirkov nr.8 Shkup

(me shenjë për Shpallje publike numër 2/23)

Zgjedhja e kandidatëve do të realizohet në afat të caktuar në nenin 23 paragrafi (2) të Ligjit për marrëdhënie pune.